



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

Nr. 1683/1 prot.

Tiranë, më 20.08.2018

URDHËR

Nr. 448/1, datë 20.08.2018

PËR

**NJË SHITESË NË URDHRIN E MINISTRIT TË MBROJTJES NR. 448, DATË 30.03.2018
“PËR MIRATIMIN E NDIHMËS FINANCIARE ME RASTIN E DITËS
PËRKUJTIMORE TË RËNIES SË PUNONJËSIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA
NË KRYE TË DETYRËS APO PËR SHKAK TË SAJ”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; germa “F”, pika 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014, datë 26.06.2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin e ministrit të Mbrojtjes nr. 448, datë 30.03.2018 “Për miratimin e ndihmës financiare me rastin e ditës përkujtimore të rënies së punonjësit të Forcave të Armatosura në krye të detyrës apo për shkak të saj”, pas pikës 2, të shtohet pika 2.1 me këtë përmbajtje:

“2.1 Dokumentet e përcaktuara në shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 2 të këtij urdhri, nuk kërkohen në rastet kur:

- familjarët janë trajtuar në përputhje me nenet 2, 3, 4, 5 ose 6 të ligjit nr. 10289/2010;
- i rëni është shpallur “Dëshmor i Atdheut”, për shkak të rënies në krye të detyrës;
- familjarët janë trajtuar njëherë sipas pikës 1 të këtij urdhri.”

Verifikimi i këtyre kushteve bëhet nga Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, e cila i kërkon prononcim zyrtar strukturave të Forcave të Armatosura dhe Ministrisë së Mbrojtjes.

2. Përgjigjen për zbatimin e këtij urdhri: Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, Qendra e Personel-Rekrutimit (QPR) dhe Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura.
3. Ndjek zbatimin e këtij urdhri sekretari i përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
Ota Xhiçka
MINISTRIA E MBROJTJES